



KOLEGJI - COLLEGE
PJETËR BUDI
PRISHTINË - PRISHTINA

APLIKIMI I SISTEMEVE MODERNE TË INFORMACIONIT NË DOGANA DHE PROCESET INTEGRUESE

MSc. Lulzim Shabani, PhD (Cand)

College "Pjetër Budi "

lulzim.shabani@hotmail.com; lulzim.shabani@rks-gov.net

MSc. Ilir Bytyci, PhD (Cand)

College "Pjetër Budi "

Ilirb2000@gmail.com

Abstrakt:

Në raportet ndërkombëtare shkëmbimi i mallrave është i një rëndësie të veçantë, prandaj roli i administratës doganore si pjesë e administratës shtetërore është që të lehtësoj këtë proces, apo që ky proces, duke ju përshtatur trendeve të zhvillimit të teknologjive të informacionit, të jetë i integruar. Edhe pse konkureshmeria në masë të madhe varet nga aktiviteti i vet subjektit ekonomik, roli i shtetit dhe i administratës doganore para së gjithash shihet si instrument për krijimin e ambientit konkurues biznesor që në njërin anë tërheq investimet e huaja, ndërsa në anën tjetër ndihmon në rritjen e potencialit eksportues për ndërmarrjet vendëse.

Mënyra e arritjes së objektivave varet para së gjithash nga vizioni dhe qëllimet e administratës doganore e cila në tendencat aktuale për subjektet ekonomike duhet të ofroj shërbime të thjeshta, të shpejta dhe efikase.

Temë e këtij kërkimi shkencor është se deri në cilën masë aplikimi i sistemeve të informacionit e lehtëson qarkullimin-këmbimin, që ai të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe si parakusht për proceset integruese nëpër të cilat po kalon regjioni në përgjithësi dhe Kosova në veçanti.

Fjalët kyçe: *Administrata, shërbimet, sistemet, informacionet, proceset.*